



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Nr. 2662 prot.,

Vlorë, më 20.01.2024

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ datë ____ . ____ 2024

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE, QË PËRFITOJNË SUBVENCIONIN E QIRASË NË TREG TË LIRË DHE VLERAT E SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR ÇDO RAST.

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM Nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë;

V E N D O S I

- I. Të miratojë listën e familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast, sipas tabelës bashkëlidhur.
- II. Efektet financiare sipas pikës 1 do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2024
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, si edhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Vlorë
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

Drejtori i Drejtorisë Juridike: D.Demiri

Drejtor i DI&IP: Z.Semani

KRYETAR

Ermal Dredha



LISTA E FAMILIWE / INDIVIDWE QE PËRITTOJE SUBVENCIONIN E QIRASE PER VITIN 2024

(Grupi i pare)

Nr. Emri	Atësia	Mbiemri	Kategoria sipas nenit 16 të ligjit nr.22/2018	Përberja familjare	Struktura e ap. sipas normave të strehimit	Sipërfaqja e ap.m2 sipas kontra- tës qirase	Qiraja mes.e apart. në treg për strukturën	Të ardhurat familjare mujore	Kategoria sipas pikës 45 të nenit 2 të ligjit 22/2018	Atësia përball. e familjes	Qiraja e përball.	Sub- vencioni mujor	Subvencioni vjetor 2024
1	Alketa	Babaje	Seltaj fam. njëpr.	3 2+1		15000	35520	Ardh. sh. ul.	15%	5328	9672	116064	
2	Dallandyshe	Rustern	Mataj fam. kom. egi.	1 garsonierë		10000	Nd. ek. 3700	0	0%	0	10000	120000	
3	Bedrie	Nexhip	Mezani fam. njëpr.	2 1+1	105	11000	Nd. ek. 3500	0	0%	0	11000	132000	
4	Qlimbia	Andrea	Velko E moshuar, lir. ban. pron	1 garsonierë	56.5	10000	20261	Ardh. sh. ul.	15%	3639	6361	76332	
5	Leonard	Festim	Shabani fam. kom. egi. 2PAK	3 2+1	74	20000	29208	0	0%	0	20000	240000	
6	Ilambi	Kostandin	Stefa I moshuar	1 garsonierë	47	10000	17230	Ardh. sh. ul.	15%	2585	7415	88980	
7	Inska	Sello	Roshi PAK	1 garsonierë	56.8	10000	Nd. ek. 10305	0	0%	0	10000	120000	
8	Figjrete	Meo	Cela Liruar ban. pronar	3 2+1	58.6	15000	12524	Ardh. sh. ul.	15%	1879	13621	163452	
9	Enkelajda	Fatmir	Bregaj fam. njëpr.	3 2+1	86	12000	35600	Ardh. sh. ul.	15%	5340	6660	79920	
10	Mvezgjen	Qani	Kovaci E mosh. lir. b. pr. kom. egi	1 garsonierë	50	10000	23837	Ardh. sh. ul.	15%	3575	6425	77100	
11	Taçjana	Muharrem	Hoxhaj E moshuar, shern. ban.	1 Garsonierë	78.30	10000	35163	Ardh. ulëta	20%	7033	2967	35604	
12	Ylli	Zini	Hoxhaj Liruar ban. pronar	2 1+1		15000	49047	Ardh. ulëta	20%	9809	5191	62292	
13	Elisiena	Aryan	Zenelej fam. njëpr.	3 1+1	47.6	10000	35600	Ardh. sh. ul.	15%	5340	4660	55920	
14	Albana	Mustafa	Lamçe fam. njëpr. 3 PAK	4 2+1	87	15000	Nd. ek. 28660	0	0	0	15000	180000	
15	Afrime	Egerem	Racaku Liruar ban. pronar	1 Garsonierë		10000	Nd. ek.	0	0	0	10000	120000	
16	Helidon	Kadri	Çuna fam. kom. egi.	2 Garsonierë	75	10000	Nd. ek.	0	0	0	10000	120000	

1787664



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

Për projekt-vendimin

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE, QË PËRFITOJNË
SUBVENCIONIN E QIRASË NË TREG TË LIRË DHE VLERAT E SUBVENCIONIT
TË QIRASË PËR ÇDO RAST.**

Pranë Bashkisë Vlorë kanë paraqitur kërkesat për të përfituar subvencionin e qirasë për vitin 2024 familje dhe individë të pastrehë, të cilët banojnë me qira në treg të lirë. Aplikimi nga ana e tyre është paraqitur pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, ku bashkë me kërkesën paraqitet edhe dokumentacioni i përcaktuar me VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”. Në zbatim të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, kreu V neni 33, 34, 35, 38, 39, të VKM Nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, subvencioni i qirasë për banesat bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, kur nuk kanë fond të lirë banesash sociale me qira, si rregull kur:

- a) Nuk zotërojnë fonde për investime të reja, ose blerje banesash në treg,
- b) Ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm se subvencioni i qirasë,
- c) Familja është në kushtet e emergjencës për strehim dhe nuk përfiton nga asnjë program tjetër.

Subvencioni i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë së tregut të lire.

Masa e subvencionit të qirasë është në varësi të të ardhurave të familjes. Për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, masa e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100% të vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Sipas nenit 2 pika 36, të ligjit nr.22/2018 datë 3.5.2018, "Qira mesatare" është mesatarja e ofertave të qirave, të marra gjatë një viti, në tregun e lirë.

Qira reale, është vlera aktuale e çmimit të qirasë së një banese të caktuar në tregun e lirë.

Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit kanë, por pa u kufizuar në to, kategoritë e mëposhtme :

- a) Individët me statusin e jetimit
- b) Personat me aftësi të kufizuar
- c) Të moshuarit
- d) Familjet me më shumë se 4 fëmijë
- e) Invalidët e punës
- f) Familjet e policëve të rënë në detyrë
- g) Azilkërkuesit
- h) Familjet e komunitetit rom
- i) Familjet e komunitetit egjiptian
- j) Viktimat e dhunës në familje
- k) Viktimat e trafikimit
- l) Prindërit e vetëm që kanë në ngarkim fëmijë
- m) Individët që i përkasin komunitetit LGBTI,
- n) Të miturit 14-18 vjeç dhe të rinjtë 18-21 vjeç, në konflikt me ligjin
- o) Vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave të specializuara
- p) Familjet me statusin e qiranarritës në banesa ish-pronë private, sipas Akti normative nr.3 datë 1.3.2012

Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.75, datë 30.09.2022 janë miratuar vlerat mesatare të qirasë së tregut të lirë në qytetin e Vlorës sipas strukturave të apartamenteve dhe vlerat maksimale të subvencionit të qirasë për familjet që përfitojnë 100 % subvencion.

Sipas VKM Nr.362 datë 29.05.2019, shtojca A, formula e përgjithshme e llogaritjes së vlerës së subvencionit të qirasë është : $S=Qm-Qp$, pra subvencioni është diferenca e qirasë mesatare të tregut të lirë me qiranë e përballeshme të familjes. Qiraja e përballeshme varet nga aftësia përballeshme e familjes dhe kjo nga të ardhurat mujore neto të çdo familje, % e të ardhurave të familjes ndaj të ardhurave mesatare të përcaktuara nga INSTAT për qarkun Vlorë (Ames, Aulta, Ashulta, A0).

Aktualisht rezultojnë se kanë paraqitur kërkesën 22 familje dhe individë. Krahas dokumentacionit për të vërtetuar kushtet e strehimit, familjare, sociale dhe ekonomike të familjeve, paraqitet edhe kontrata e qirasë e nënshkruar mes palëve qiramarrëse dhe qiradhënëse, si edhe vërtetimi për numrin e llogarisë në bankë të palës qiradhënëse, ku kalon subvencioni i qirasë që përfitojnë familjet. Nga 22 familjet në total, pjesë e këtij projekt-vendimi janë vetëm 16 familje, rastet e tjera do të paraqiten me projekt-vendimet në muajt pasardhës, pasi të kompletohen kërkesat me dokumentacionin e munguar.

Sipas nenit 16, të ligjit 22/2028, këto familje përfaqësojnë:

- familje njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç
- familje/individë përfitues të ndihmës ekonomike, ose pa të ardhura
- familje/individë me të ardhura shumë të ulëta dhe të ulëta, krahasuar me të ardhurat mesatare sipas INSTAT për qarkun Vlorë.
- familje të komunitetit egjiptian,
- individë të moshuar të vetmuar që jetojnë me pension pleqërie
- persona PAK që trajtohen me ndihmë ekonomike invaliditeti, etj.

Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 12/02/2024 mori në shqyrtim të gjitha kërkesat së bashku me dokumentacionin e paraqitur.

Bazuar në dokumentacionin përkatës të çdo aplikanti, në rezultatet e verifikimit në terren të banesave dhe të kushteve të banimit, bazuar në aktet ligjore në fuqi për përcaktimin e masës së subvencionit, komisioni arriti në konkluzionet të cilat i miratoi në grup.

Komisioni i Strehimit miratoi:

1. Familjet/individët që përfitojnë subvencionin e qirasë së tregut të lirë dhe masën e subvencionit rast pas rasti.
2. Familjet që janë ende në proces të përgatitjes së dokumentacionit dhe të verifikimit në terren do të trajtohen në vijim, në varësi të plotësimit të dokumentacionit.
3. Për z.Helidon Çuna të miratojë dhënien e subvencionit të qirasë dhe ti kërkohet punonjësit të policisë të rajonit të monitorojë vendbanimin real të këtij personi, për shkak të problematikës që ka shfaqur ky rast.
4. Znj. Dallandyshe Mataj të përfitojë subvencionin e qirasë sipas vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
5. Familjet e reja që aplikojnë për të përfituar subvencionin e qirasë dhe nuk rezultojnë të punësuar, pra nuk kanë të ardhura, nuk ka problematika sociale apo shëndetësore, të mos trajtohen me përfitimin e subvencionit të qirasë.
6. Për z. Ylli Hoxhaj, banon me qira në tregun e lirë prej vitit 2013 kur ka liru banesën e ish-pronarit, është kualifikuar në listën e pritjes për apartament (1+1) në lagjen "Kushtrimi". Nëse do të bëhet realisht përfitues me EKB dhe do të lidhë kontratën, do të ndërpritet përfitimi i subvencionit të qirasë.

Sa më lart, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë projekt-vendimin e paraqitur për të ndihmuar me pagesat e qirasë familjet në nevojë që kërkojnë mbështetje nga Bashkia Vlorë.

Konceptoi: D.Mustafai

Miratoi: Z.Selmani



KRYETAR

Ermal Dredha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 2602 prot.,

Vlorë, më 20 . 02 .2024

MIRATOHET
KRYETAR

Ermal Dredha

VENDIM

Nr. 1, datë 12.02.2024

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë, i mbledhur sot në datën 12.02.2024, pasi mori në shqyrtim kërkesat e qytetarëve bashkë me dokumentacionin përkatës, për të përfituar nga projekti i subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024;

KONSTATOI SE

Deri në datën e sotme 12.02.2024 kanë paraqitur kërkesat rreth 22 familje dhe individë të pastrehë, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë mundësi ekonomike për të përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë. Bashkë me pamundësinë ekonomike këto familje paraqesin një sërë problematikash familjare dhe sociale. Një pjesë e aplikantëve e kanë kërkesën të përsëritur dhe janë përfitues prej vitesh të bonusit të qirasë. Banesat dhe kushtet e banimit sipas kontratave të qirasë janë verifikuar në terren së bashku me rajonet ku ndodhen këto banesa. Po kështu janë verifikuar në terren banesat e aplikantëve të rinj dhe kushtet e banimit sipas kontratave të qirasë.

Sa më lart komisioni,

VENDOSI

1. Të shqyrtojë të gjitha kërkesat dhe dokumentacionin e familjeve/individëve, që janë regjistruar pranë Bashkisë Vlorë për të përfituar subvencionin e qirasë në treg të lirë për vitin 2024, të gjitha rastet e verifikuara në terren nga sektori që mbulon strehimin në bashkëpunim me rajonet, në adresat e banimit sipas kontratës së qirasë.

2. Kërkesat e paplotësuara dhe të paverifikuara të shqyrtohen në mbledhjet e ardhshme të komisionit.

3. Të përcaktojë masën e subvencionit të qirasë që përfiton çdo aplikant

4. Të miratojë dhënien e subvencionit të qirasë dhe vlerat përkatëse për 16 familje dhe individë sipas tabelës së mëposhtme, që do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2024.

5. Për z. Helidon Çuna të miratojë dhënien e subvencionit të qirasë dhe ti kërkohet punonjësit të policisë së rajonit të monitorojë vendbanimin real të këtij personi, për shkak të problematikës që ka shfaqur ky rast.

6. Znj. Dallandyshe Mataj të përfitojë subvencionin e qirasë sipas vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

7. Familjet e reja që aplikojnë për të përfituar subvencionin e qirasë, nuk rezultojnë të punësuar, pra nuk deklarojnë të ardhura dhe, nuk ka problematika sociale apo shëndetësore, të mos trajtohen me subvencionin e qirasë.

8. Për z. Ylli Hoxhaj, banon me qira në tregun e lirë prej vitit 2013 kur ka liru banesën e ish-pronarit, është kualifikuar në listën e pritjes për apartament (1+1) në lagjen 'Kushtrimi'. Nëse do të bëhet realisht përfitues me EKB dhe do të lidhë kontratën, do ti ndërpritet përfitimi i subvencionit të qirasë.

Nr	Emër /Atësia/ Mbiemër	Të ardhurat mujore (lekë)	Qiraja mesatare në treg të lirë	Subvencioni lekë/muaj	Subvencioni vjetor lekë/muaj
1.	Alketa Babaçe Seitaj	35520	15000	9672	116064
2.	Dallandyshe Rustem Mataj	Nd.ek. 3700	10000	10000	120000
3	Bedrie Nexhip Mezani	Nd.ek. 3500	11000	11000	132000
4	Olimbia Andrea Velko	20261	10000	6361	76332
5	Leonard Festim Shabani	Nd.ek 29208	20000	20000	240000
6	Llambi Kostandin Stefa	17320	10000	7415	88980
7	Ineska Selfo Roshi	Nd.ek.PAK	10000	10000	120000
8	Fiqirete Meto Çela	12524	15000	13621	163452
9	Enkelejda Fatmir Bregaj	35600	12000	6660	79920
10	Myzegjen Qani Kovaçi	23837	10000	6425	77100
11	Tatjana Muharrem Hoxhaj	35163	10000	2967	35604
12	Ylli Zini Hoxhaj	49047	15000	5191	62292
13	Elisiena Arjan Hoxhaj	35600	10000	4660	55920
14	Albana Mustafa Lamçe	Nd.ek.28660	15000	15000	180000
15	Afrime Eqerem Racaku	Nd.ek.	10000	10000	120000
16	Helidon Kadri Çuna	Nd.ek.	10000	10000	120000

5. Me përfundimet e mësipërme të përgatitet projekt vendimi që do të paraqitet për miratim në Këshillin e Bashkisë.

KOMISIONI

1. Irena Toshkallari
2. Zambak Selmani
3. Dorian Demiri
4. Ali Çakërri
5. Orest Ruçaj
6. Manuela Prifti
7. Donald Leskaj

8. Brisilda Çobaj
9. Kanan Shakaj
10. Genard Fegaj
11. Selim Haskoçelaj
12. Birçe Aliraj
13. Drita Mustafai